Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Misioni në Shkup**

# Plan për aktivitete vjetore për vitin 2024, të cilat rezultojnë nga Memorandumi i bashkëpunimit midis Misionit të OSBE-së në Shkup dhe Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit 2023 – 2024

Programi: DEMOKRATIZIMI

| **Aktiviteti** | **Përshkrimi i aktivitetit** | **Përgjegjës për zbatimin** | **Periudha e implementimit (preliminare)** |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti 1: Rritja e vetëdijes së kryetarëve të komunave për konceptin e integritetit si politikë për parandalim të korrupsionit** | | | |
| Me qëllim të promovimit të politikës për integritet dhe për të siguruar përkushtim të udhëheqjes të lartë në njësitë e vetëqeverisjes lokale, Misioni i OSBE-së dhe KSHPK-ja do të organizojnë katër brifing sesione regjionale për kryetarët e komunave të të gjitha 81 njësi të vetëqeverisjes lokale. Ata të cilët tashmë e kanë nënshkruar Deklaratën për integritet politik, do të kenë mundësi të njihen me detyrimet për implementimin e elementeve të sistemit të integritetit. 13 kryetarë të komunave do të njihen me konceptin dhe do t'iu rikujtohet të nënshkruajnë politikën për integritet.<br>Sesionet brifing do të mbahen nga Kryetarja/anëtarët të Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe përfaqësueses me njësinë për demokratizim të Misionit të OSBE-së në Shkup. | 1. Përcaktimi i datave për takimet rajonale me kryetarët e komunave | OSBE/KSHPK | Maj 2024 |
| | 2. Rezervimi i hoteleve për akomodim për takimet regjionale | OSBE | Maj 2024 |
| | 3. Dërgesa e ftesave dhe vendosja e kontakteve të drejt për drejtë për konfirmim të pjesëmarrjes | KSHPL | Qershor 2024 |
| | 4. Zhvillimi i 4 takimeve regjionale me kryetarët e komunave | OSBE/KSHKP | Qershor - Shtator 2024 |
| | | | |

| Aktiviteti 2: Përkrahje për implementimin e elementëve të sistemit të integritetit për njësitë e vetëqeverisjes lokale | | | |
|---|---|---|---|
| Misioni dhe KSHPK-ja do të përmbajë administratat lokale për forcimin e sistemit të integritetit. Do të angazhohen ekspertë(e) teknike dhe do të organizohen katër trajnime dy-ditore për nëpunësit për integritet dhe personelit të administratës, duke mbuluar të gjithë elementet të politikës për integritet, dhe t'iu ndihmohen në tejkalimin e sfidave gjatë implementimit.<br>Gjithashtu, do të përgatitet një Doracak për parandalimin e konfliktit të interesit në NJVL, tek i cili do të prezantohen pyetjet dhe përgjigjet kyçe të procesuara nga KSHPK-ja për nëpunësit lokal, të cilët kërkojnë shpjegim për konflikte të interesit të vërteta, potenciale dhe të dukshme në fusha të ndryshme. Publikimi do të publikohet në tre gjuhë në faqet e internetit të OSBE-së dhe KSHPK-së | 1. Procedimi i TOR për angazhimin e ekspertëve/eksperteve për trajnimet për elementet e sistemit të integritetit në NJVL dhe Doracakut për konflikt të interesit në NJVL | OSBE / KSHPK | Mars 2024 |
| | 2. Përcaktimi i terminëve dhe dinamika e zhvillimit të trajnimeve regjionale për elementet të sistemit të integritetit dhe rezervimi i hoteleve për akomodim | OSBE / KSHPK | Maj – Gusht 2024 |
| | 3. Përzgjedhja e ekspertëve për elementet e sistemit për integritet dhe nënshkrimi i kontratave | OSBE / KSHPK | Qershor 2024 |
| | 4. Përgatitja e kurikulumit dhe prezantimeve për trajnimet për elementet e sistemit për integritet dhe miratimi i tyre nga KSHPK-ja dhe OSBE-ja | Ekspertë të përzgjedhur/trajnues | Korrik – Gusht 2024 |
| | 5. Realizimi i katër trajnimeve dy-ditore regjionale për oficerët e integritetit dhe administratën lokale për elementet e sistemit të integritetit | OSBE / KSHPK / ekspertë | Shtator - Tetor 2024 |
| | 6. Përcaktimi i strukturës së manualit për konflikt të interesit me ekspertin/eksperten e përzgjedhur | KSHPK/ NJVL/ ekspert(e) | Maj 2024 |
| | 7. Përgatitja e manualit për konflikt të interesit | Ekspert(e) | Qershor -Gusht 2024 |
| | 8. Përkthimi i manualit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, dhe lekture në gjuhën mk/al/en. | Organizatë / OSBE | Shtator - 2024 |
| | 9. Dizajni i publikimit dhe publikimi ne faqet e internetit të KSHPK-së dhe OSBE-së | Organizatë / OSBE | Tetor - Nëntor 2024 |

| Aktivitet 3. Analiza gjinore e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit | | | |
|---|---|---|---|
| Misioni do të mbështesë KSHPK-në në fillimin e aktiviteteve për herë të parë për përfshirjen e komponentëve gjinore në krijimin, implementimin, monitorimin dhe evaluimin e politikave antikorruptive dhe punën e KSHPK-së. Në vitin 2024 do të realizohet analiza gjinore për Komisionin shtetëror për parandalim të korrupsionit, që do të paraqesë analizë e parë gjinore e realizuar në këtë trup antikorruptiv në Maqedoninë e Veriut dhe më gjerë. Metodologjia për përfshirjen e aspekteve gjinore në punën e KSHPK-së, duke marrë parasysh dhe sugjerimet e UNODC0-së për përfshirjen e perspektivës gjinore në projektet/programet antikorruptive[1]. | 1. Përzgjedhja dhe nënshkrimi i kontratës me ekspert/eksperte kombëtare për udhëheqjen e procesit për analizë gjinore në KSHPK, nga lista e Misionit të OSBE-së në Shkup | OSBE | Maj 2024 |
| | 2. Përcaktimi i Metodologjisë për analizë gjinore dhe miratimi i saj | Ekspert/eksperte kombëtare | Qershor 2024 |
| | 3. Desk-research / dokumentacioni aktual dhe të legjislativës. | Ekspert/eksperte kombëtare | Qershor/ korrik 2024 |
| | 4. Hulumtim në teren me palë të interesit të brendshëm dhe të jashtëm dhe punëtori për sensitivizimin e të punësuarve dhe anëtarëve për KSHPK me dimensionin gjinor në politikat antikorruptive . | Ekspert/eksperte kombëtare / OSBE / KSHPK | Shtator 2024 |
| | 5. Përgatitja e analizës / raportit | Ekspert/eksperte kombëtare | Tetor 2024 |
| | 6. Punëtori përfundimtare për finalizimin e raportit për analizë gjinore dhe miratimi i saj nga ana e KSHPK-së | Ekspert/eksperte kombëtare / OSBE / KSHPK | Tetor 2024 |
| | 7. Përkthim i raportit në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze dhe lekturë në mk/al/en. | Organizatë / OSBE | Nëntor 2024 |
| **Aktiviteti 4; Trajnim për barazi gjinore për Koordinatorët për mundësi të barabarta në KSHPK (pa implikime buxhetore)** | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Në bazë të kërkesës të dërguar nga KSHPK-ja, Misioni do të realizojë programe për trajnim hyrës në temën e barazisë gjinore dhe aspektet gjinore të korrupsionit. Trajnimin do ta zhvillojnë të punësuarit nga Misioni i OSBE-së për nevojat e koordinatores dhe zëvendës koordinatorit për barazi gjinore pranë KSHPK-së. Para zhvillimit të trajnimit, të punësuarit nga Misioni do të bëjnë vlerësim për nevojën e trajnimit. Ky aktivitet do të jetë vazhdim i aktivitetit të analizës gjinore të parë në KSHPK, në gjysmën e dytë të vitit 2024. | 1. Takim koordinues për përcaktimin e dinamikës të programit për trajnim të përfaqësuesve të KSHPK-së | OSBE / KSHPK | Mars 2024 |
| | 2. Realizimi i vlerësimit të nevojave për trajnim | OSBE | Prill 2024 |
| | 3. Dizajnimi i programit për trajnim | OSBE | Maj 2024 |
| | 4. Realizimi i programit për trajnim | OSBE / KSHPK | Qershor-Shtator 2024 |
| | 5. Përgatitja e raportit me mësimet e mësuara dhe plani i veprimit për përfshirjen e perspektivës gjinore në punën e KSHPK-së. | OSBE / KSHPK | Tetor 2024 |